VENDIM
Nr. 41, datë 26.3.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	kryetare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare;
Ilir Toska,	anëtar;
Genti Ibrahimi,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Asim Vokshi	anëtar;
Sandër Beci,	anëtar,

me sekretare Farisja Idrizaj, në datat 5.3.2026 dhe 26.3.2026, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve kërkesën nr. 3 (R) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Redi Molla, përfaqësuar nga avokati Ermir Beta, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përfaqësuar nga prokurori Klodjan Braho.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 352, datë 24.6.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 164 (87-2024-223), datë 31.7.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2024-1979 (299), datë 4.12.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 30, 32, pika 2, 42, 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 5 dhe 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim pretendimet dhe prapësimet e kërkuesit Redi Molla (*kërkuesi)*, që ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar *(Prokuroria e Posaçme)*, e cila ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi dhe shtetasi M. Q. nga muaji gusht i vitit 2015 deri në shkurt të vitit 2016 kanë qenë të punësuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, në varësi të Bashkisë së Tiranës. Në muajin shkurt të vitit 2016 kërkuesi është punësuar në shoqërinë "Ujësjellës-Kanalizime Tiranë" sh.a., në pozicionin e drejtorit të përgjithshëm, dhe në muajin mars të po atij viti edhe shtetasi M. Q. është punësuar në të njëjtën shoqëri, në pozicionin e drejtorit të departamentit mbështetës.

2. Ndërkohë, në datën 22.1.2016, është regjistruar shoqëria "Igor Elektrik" sh.p.k., e themeluar nga ortaku i vetëm dhe administratori i saj, shtetasi E. M., me objekt të veprimtarisë, ndër të tjera, edhe ndërtimin e rrjeteve inxhinierike të ujësjellësit. Nëpërmjet kontratave të shitblerjes të datave 27.1.2017 dhe 7.12.2018, aksionet në masën 100% janë zotëruar nga shtetasi M. P. dhe administrimi është kryer nga shtetasi N. M. Në datën 7.1.2019, është regjistruar në regjistrin tregtar ndryshimi i emrit të shoqërisë në "V.A.S. Konstruksion" sh.p.k., si dhe është pasqyruar vendimi i ortakut të vetëm për rritjen e kapitalit të shoqërisë nga 100 lekë në 1.000.000 lekë. Në vijim, në datën 4.3.2021, aksionari i vetëm i ka shitur administratorit të shoqërisë 100% të aksioneve për një vlerë prej 1.000.000 lekë, dhe ky i fundit, në cilësinë e aksionarit të vetëm dhe të administratorit, i ka ndryshuar sërish emërtimin në "5D Konstruksion" sh.p.k. Kjo shoqëri ka marrë pjesë dhe është shpallur fituese në disa procedura prokurimi për periudhën 2016–2022 nga institucionet publike, ndër të cilat ka rezultuar fituese në 13 procedura prokurimi të shpallura nga autoriteti kontraktor, Bashkia e Tiranës, ose institucione në varësi të saj, si dhe në 10 procedura prokurimi të shpallura nga autoriteti kontraktor, shoqëria "Ujësjellës-Kanalizime Tiranë" sh.a.

3. Prokuroria e Posaçme ka regjistruar procedimin penal nr.75, datë 27.4.2023 (*procedimi penal nr. 75/2023*) për veprat penale "Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tenderë dhe në ankande publike" dhe "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", të parashikuara nga nenet 258, paragrafi i dytë, dhe 259, paragrafi i dytë, të Kodit Penal (*KP*). Po kështu, Prokuroria e Posaçme, mbi bazën e kallëzimit të bërë nga shtetasi B. K., ka regjistruar procedimin penal nr. 121, datë 23.5.2023, (*procedimi penal nr. 121/2023*) për veprat penale "Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tenderë dhe në ankande publike" dhe "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", të parashikuara nga nenet 258, paragrafi i dytë dhe 259, paragrafi i dytë, të KP-së.

4. Në vijim të procedimit penal nr. 5/2023 janë kryer veprime hetimore dhe me vendimin nr. 401, datë 11.10.2023, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar *(GJKKO-ja e Shkallës së Parë)* është ushtruar kontroll në mjediset e zyrës së shoqërisë "5D Konstruksion" sh.p.k., duke sekuestruar dokumente, njësi kompjuterike dhe aparate të telefonisë celulare, të cilat më pas u janë nënshtruar ekspertimeve teknike kompjuterike, nga ku janë gjetur të dhëna se ortakët e vërtetë të kësaj shoqërie janë kërkuesi dhe shtetasi M. Q., të cilët dyshohet se e kanë zotëruar në mënyrë të tërthortë që prej vitit 2016.

5. Pas kryerjeve të veprimeve hetimore, Prokuroria e Posaçme ka paraqitur kërkesë për caktimin e masave të sigurimit "Arresti në burg" ndaj personave nën hetim, kërkuesit dhe shtetasit tjetër, për veprat penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", të kryer në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 259 e 25, të KP-së dhe "Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë, ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin për deklarim", e kryer disa herë.

6. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 28, datë 28.3.2024, ka miratuar kërkesën dhe ka caktuar ndaj kërkuesit masën e arrestit në burg, të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), për kryerjen e veprave penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike" në shtatë raste, nga këto katër raste të kryera në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 259 dhe 25 të KP-së, dhe "Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë, ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin për deklarim" të kryer në pesë raste, të parashikuar nga neni 257, shkronja "a", pika 2, i KP-së. Në datën 29.3.2024, Prokuroria e Posaçme ka dërguar për gjykim kërkesën për verifikimin dhe vazhdimin e masës së sigurimit personal dhe marrjes në pyetje ndaj personave nën hetim, përfshirë edhe kërkuesin.

7. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr.35, datë 30.3.2024, ka vendosur, ndër të tjera, vazhdimin e masës së sigurimit "Arresti në burg", të parashikuar nga neni 238 i KPP-së ndaj kërkuesit si person i hetuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 259 dhe 25 të KP-së dhe 257, shkronja "a", pika 2, i KP-së. Për ankimin e kërkuesit, Gjykata e Posaçme e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me vendimin nr. 18 (87-2024-123), datë 3.5.2024, ka vendosur miratimin e vendimeve nr. 28, datë 28.3.2024 dhe nr. 35, datë 30.3.2024, të GJKKO-së së Shkallës së Parë. Ndërkohë, për rekursin e kërkuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1588 (232), datë 26.9.2024, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 18 (87-2024-123), datë 3.5.2024, të GJKKO-së së Apelit për kërkuesin dhe personin tjetër nën hetim, duke e dërguar çështjen për rishqyrtim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues, me arsyetimin se gjyqtari i hetimit paraprak në gjykatën e apelit ka marrë kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprake, duke ushtruar kontroll mbi veprimtarinë e prokurorit, nëpërmjet kualifikimit të veprës penale. Kolegji Penal ka udhëzuar GJKKO-në e Apelit të marrë në shqyrtim vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë për masat e sigurisë ndaj kërkuesit dhe personit tjetër nën hetim, duke vlerësuar raportin e masave të sigurimit me rëndësinë e faktit, dhe sanksionin për veprat penale të kualifikuara nga organi i akuzës, deri në fazën aktuale të hetimeve.

8. GJKKO-ja e Apelit, me vendimin nr. 57 (87-2024-323), datë 7.11.2024, ka vendosur miratimin e vendimeve nr. 28, datë 28.3.2024 dhe nr. 35, datë 30.3.2024, të GJKKO-së Shkallës së Parë për llojin e masës së sigurimit "Arresti në burg" të caktuar ndaj kërkuesit, me arsyetimin se është më e përshtatshme me shkallën e nevojave të sigurimit, me rëndësinë e fakteve dhe me sanksionet e parashikuara për veprat penale.

9. Në datën 28.5.2024, në GJKKO-në e Shkallës së Parë është regjistruar kërkesa penale me nr. 313 akti e paraqitur nga personi tjetër nën hetim, shtetasi M. Q., me objekt paraqitjen e informacionit dymujor dhe verifikimin e kushteve e të kritereve që lidhen me nevojat e sigurimit ndaj personit nën hetim dhe zëvendësimin e masës së sigurimit në zbatim ndaj tij me një masë sigurimi më të butë. Në datën 30.5.2024, është regjistruar kërkesa penale me nr. 320 akti nga kërkuesi si person nën hetim, me objekt të njëjtë me shtetasin nën hetim, M. Q. Në datën 10.6.2024, është regjistruar kërkesa penale me nr. 352 akti e Prokurorisë së Posaçme, me objekt paraqitjen e informacionit dymujor për ecurinë e hetimeve ndaj kërkuesit dhe dy shtetasve të tjerë nën hetim, M. Q. dhe T. T. Me vendimin e datës 12.6.2024, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vendosur bashkimin e kërkesave penale me nr. 313 akti dhe nr. 320 akti me kërkesën penale nr. 352 të Prokurorisë së Posaçme, pasi të tria këto lidhen me procedimin penal nr. 75/2023, gjenden për shqyrtim në të njëjtën fazë procedurale, përpara së njëjtës gjykatë, si dhe në thelb kanë të njëjtin objekt.

10. Sipas Prokurorisë së Posaçme, referuar informacionit me shkrim dhe qëndrimit të mbajtur gjatë zhvillimit të gjykimit, në funksion të procedimit penal në ngarkim të kërkuesit, shtetasit M. Q. e personave të tjerë që hetohen në kuadër të të njëjtit procedim, janë kryer një sërë veprimesh hetimore, si: sekuestrimi i aparateve të telefonisë celulare, kryerja e ekspertimit teknik kompjuterik, ekspertimi teknik për llogaritjen e fondit limit për procedurat e prokurimit të gjetura me shkelje, si dhe janë kryer veprime hetimore që lidhen me mënyrën e qarkullimit të shumave monetare nga shoqëria "5D Konstruksion" sh.p.k., me burimin e të ardhurave të investuara nga shoqëria në aktivitete të tjera, si dhe me shumat monetare që janë përfituar nga zotëruesit e shoqërisë tregtare.

11. Nga ana tjetër, me vendimin e datës 23.5.2023, Prokuroria e Posaçme ka vendosur bashkimin e dy procedimeve penale nr. 75/2023 dhe nr. 121/2023, të regjistruara mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasit B. K., në një procedim penal me nr. 75/2023. Në vijim të hetimeve,

me urdhrin e datës 4.6.2024, Prokuroria e Posaçme ka bërë ndryshime në regjistrin e njoftimeve të veprave penale të regjistrimit të personit që i atribuohet vepra penale, duke urdhëruar regjistrimin e veprës penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale", të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 287, paragrafi 2, i KP-së. Po kështu, sipas këtij urdhri të Prokurorisë së Posaçme, është regjistruar si person nën hetim personi juridik, shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar "5D Konstruksion sh.p.k.", si subjekt i dyshuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 244 dhe 25, si dhe 287 të KP-së. Sipas Prokurorisë së Posaçme, për një hetim të plotë duhen kryer veprime të tjera hetimore në drejtim të grumbullimit të provave të tjera në ngarkim të personave nën hetim, përfshirë edhe kërkuesin.

12. Kërkuesi, nëpërmjet avokatit mbrojtës, ka kundërshtuar në GJKKO-në e Shkallës së Parë masën e sigurimit, duke pretenduar se ajo është e papërshtatshme e duhet zëvendësuar me një masë më të butë, pasi: i. kërkuesi është marrë i pandehur me urgjencë për disa vepra penale, për shkak të parashkrimit, pa u thirrur për të dhënë shpjegime e sqarime paraprakisht. Në dy muajt e masës së arrestit në burg nuk ka pasur përpjekje për ta marrë në pyetje për faktet që i atribuohen; ii. mungon dyshimi i arsyeshëm dhe kërkuesi nuk mund të qëndrojë në arrest në burg në fazën ku gjendet procedimi penal, pasi hetimet do të zgjasin për shkak të akteve të ekspertimit që duhet të administrohen; iii. duke marrë të mirëqenë rrezikshmërinë shoqërore të veprave, kërkuesi njihet për një reputacion të mirë, si dhe nga momenti i ushtrimit të kontrollit në zyrat e shoqërisë "5D Konstruksion sh.p.k.", në tetor 2023, ai nuk ka kryer asnjë veprim për të dëmtuar provat ose për t'iu shmangur hetimeve. Me kërkesë të njëjtë i janë drejtuar GJKKO-së së Shkallës së Parë edhe dy personat nën hetim, shtetasit M. Q. dhe T. T.

13. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 352, datë 24.6.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuesit dhe të dy personave të tjerë nën hetim, për zëvendësimin e masës së sigurimit personal "Arresti në burg" dhe vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit të caktuar ndaj tij me vendimin nr.28, datë 28.3.2024, të GJKKO-së së Shkallës së Parë, lënë në fuqi me vendimin nr. 18 (87-2024-123), datë 3.5.2024, të GJKKO-së së Apelit. Ajo gjykatë ka vlerësuar se në drejtim të kontrollit për ecurinë e hetimeve dhe vlerësimit të diligjencës së organit të hetimit në kryerjen e tyre gjatë zbatimit të masës së sigurimit "Arresti në burg" ndaj personave nën hetim, Prokuroria e Posaçme ka kryer një sërë veprimesh hetimore për procedimin në tërësi. Referuar informacionit dymujor të paraqitur nga Prokuroria e Posaçme, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se kushtet e përgjithshme dhe të posaçme për caktimin e masave dhe përshtatshmëria e tyre nuk rezultojnë të kenë pësuar ndryshime thelbësore, pasi personat e hetuar vijojnë të jenë në hetim për të njëjtat fakte, për të njëjtat vepra penale, mbartin të njëjtën rrezikshmëri shoqërore të vlerësuar nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë në momentin fillestar dhe e gjetur e drejtë edhe nga gjykata më e lartë që ka shqyrtuar ankimin e personave nën hetim, duke miratuar masat e caktuara prej tyre. Në këtë fazë të hetimit nuk ka rezultuar të jenë bërë ndryshime të cilësimit ligjor të faktit penal me pasojë ridimensionimin e nevojave të sigurimit personal në drejtim të lehtësimit të tyre. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim kërkuesi dhe personi nën hetim, M. Q.

14. GJKKO-ja e Apelit, me vendimin nr. 164 (87-2024-223), datë 31.7.2024, ka vendosur miratimin e vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë, duke vlerësuar se shkaqet e parashtruara në apelet e kërkuesit dhe të personit tjetër nën hetim janë të pabazuara në fakte dhe në ligj. Ndryshe nga Prokuroria e Posaçme dhe GJKKO-ja e Shkallës së Parë, GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar se ato nuk kanë reflektuar në qëndrimet e tyre për kualifikimin juridik të fakteve penale historike objekt procedimi, pavarësisht pjesës relevante arsyetuese të vendimit nr. 18 (87-2024-123), datë 3.5.2024, të GJKKO-së së Apelit. Sipas kësaj të fundit, konstatohet se për dy personat nën hetim nuk ka asnjë rrethanë që ka relativizuar rëndësinë juridike dhe faktike të fakteve penale historike

të cilat u atribuohen, përkundrazi ka veprime hetimore të mëtejshme që e konsolidojnë bindjen për autorësinë e tyre dhe për aktivizimin e përgjegjësisë penale të tyre për veprat penale të rezultuara deri më tani se janë konsumuar sipas pikëpamjes juridike të ndryshme të GJKKO-së së Apelit. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuesi.

15. Për rekursin e kërkuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1979 (299), datë 4.12.2024, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të GJKKO-së së Apelit. Ajo gjykatë ka vlerësuar se pretendimet e kërkuesit se gjykata e apelit ka marrë kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprake për kualifikimin ndryshe të bashkëpunimit nga ai i thjeshtë, në grup të strukturuar kriminal, janë marrë në shqyrtim nga Gjykata e Lartë me vendimin e datës 26.9.2024, duke vendosur, ndër të tjera, prishjen e vendimit të GJKKO-së së Apelit, dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues, me arsyetimin se gjyqtari i hetimit paraprak në gjykatën e apelit ka marrë kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprake, duke ushtruar kontroll mbi veprimtarinë e prokurorit, nëpërmjet kualifikimit të veprës penale. Gjykata e Lartë ka vlerësuar se gjykatat e faktit kanë marrë në shqyrtim informacionin dymujor për gjendjen e procedimit penal, si dhe kërkesën për zëvendësimin e masës së sigurimit ku gjerësisht është arsyetuar se nevojat e sigurimit nuk janë zbutur. Sipas Gjykatës së Lartë, shkaqet e paraqitura në rekurs nuk janë të tilla që të cenojnë vendimmarrjen e GJKKO-së së Apelit, si dhe nuk ka mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural, me rëndësi për zhvillimin ose njësimin e praktikës gjyqësore, nuk ka mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave, vendimi i ankimuar nuk bie në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe, për pasojë, nuk ndodhet në asnjë nga rastet e parashikuara nga neni 432 i KPP-së në kohen e depozitimit.

16. Në datën 30.4.2025, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit. Në datën 26.6.2025, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur pranimin e kërkesës së një anëtari të saj për heqjen dorë nga shqyrtimi i kësaj çështjeje. Në datën 10.7.2025, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila, në datën 23.7.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

17. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

17.1 *Liria personale, e garantuar nga neni 27, pikat 1 dhe 2, shkronja "c", të Kushtetutës, dhe neni 5, pika 1, shkronja "c", i KEDNJ-së, në drejtim të standardit të dyshimit të arsyeshëm dhe të proporcionalitetit,* si rrjedhojë e mospranimit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm të kërkesës së tij për zëvendësimin e masës "Arresti në burg". Gjatë periudhës së kryerjes së hetimeve kërkuesi nuk ka ndërmarrë ose tentuar ndonjë veprim të çfarëdoshëm për të dëmtuar provat ose për t'u larguar, ndaj arsyet e përmendura për bazueshmërinë e caktimit të masës së sigurimit nuk i përgjigjen shkakut të vërtetë të arrestimit të tij, por janë arbitrare dhe pasqyrojnë një arsyetim formal dhe të përgjithshëm të kritereve të përgjithshme e të veçanta për caktimin e masës së sigurimit nga gjykatat, duke u bazuar vetëm në rrezikshmërinë e veprës dhe ashpërsinë e dënimit, pa dhënë asnjë rrethanë konkrete se në çfarë mënyre ose me çfarë veprimi kërkuesi plotësonte kriteret e parashikuara nga neni 228, paragrafi 3, i KPP-së. Caktimi i një mase të sigurimit personal më të ashpër, në kushtet kur synimi mund të arrihej edhe nëpërmjet masave më të lehta, e bën

masën e caktuar ndaj joproporcionale me akuzat në ngarkim të tij dhe me situatën faktike në momentin e caktimit të kësaj mase kur hetimet tashmë ishin kryer. Çdo kufizim i lirisë duhet të respektojë në mënyrë të veçantë të drejtën e shëndetit dhe të dinjitetit të të paraburgosurit, që, në rastin konkret, është në disproporcion flagrant me gjendjen e rënduar shëndetësore të kërkuesit (*shih Ebedin Abi kundër Turqisë, datë 13.3.2018, të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ)*).

17.2 *E drejta për proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

17.2.1 *Parimit të paanshmërisë,* pasi GJKKO-ja e Apelit, me vendimmarrjen e saj, ka rënduar pozitën e kërkuesit, ka tejkaluar kufijtë e shqyrtimit në gjykatën e apelit, duke shtuar fakte e akuza që nuk janë pretenduar as nga prokurori dhe as nga gjykata e shkallës së parë, si dhe ka caktuar një masë sigurimi ekstreme në mungesë totale të arsyetimit mbi pretendimin e mbrojtjes për pavlefshmëri të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë. Ajo gjykatë e ka tejkaluar pragun e shfaqjes së një mendimi ose sugjerimi mbi formën e bashkëpunimit, apo kualifikimin e faktit penal në ngarkim të kërkuesit, duke u shprehur me bindje në arsyetimin e saj se ai është fajtor e tenton të orientojë prokurorinë që të veprojë sipas bindjes së saj.

17.2.2 *Parimit të sigurisë juridike*, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1588 (232), datë 26.9.2024, e ka dërguar çështjen për rishqyrtim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues, me arsyetimin se gjyqtari i hetimit paraprak në gjykatën e apelit ka marrë kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprake, duke ushtruar kontroll mbi veprimtarinë e prokurorit nëpërmjet kualifikimit të veprës penale, duke rekomanduar GJKKO-në e Apelit të marrë në shqyrtim vendimin e GJKKO-së së Shkallës së parë për masat e sigurisë ndaj kërkuesit dhe personit tjetër nën hetim, duke vlerësuar raportin e masave të sigurimit me rëndësinë e faktit dhe sanksionin për veprat penale të kualifikuara nga organi i akuzës, deri në fazën aktuale të hetimeve. Ndërkohë që GJKKO-ja e Apelit ka mbajtur të njëjtin qëndrim si në vendimin nr.18 (87-2024-123), datë 3.5.2024, me doza të thella paragjykimi dhe me bindjen e plotë se ai është fajtor, por për akuza edhe më të rënda nga sa pretendon organi i akuzës, Kolegji Penal, me vendimin e datës 4.12.2024, ka anashkaluar haptazi qëndrimin e Gjykatës së Lartë në vendimin e datës 26.9.2024, duke mbajtur i njëjti trup gjykues qëndrim katërcipërisht të kundërt për të njëjtin fakt në dy momente të ndryshme.

17.3 *Parimi i prezumimit të pafajësisë,* i garantuar nga neni 30 i Kushtetutës, pasi GJKKO-ja e Apelit e ka konsideruar kërkuesin dhe personat nën hetim si fajtorë, ndonëse çështja ndodhet ende në fazën e hetimeve, duke e rikualifikuar faktin penal, sipas neneve 143, paragrafi 3, 287 dhe 334, paragrafi 1, të KP-së, për kryerjen e veprës penale nga të hetuarit nën formën e një grupi të strukturuar kriminal, sipas nenit 28, paragrafi 4, të KP-së, duke rënduar pozitën e tyre.

17.4 *Të drejtat dhe liritë themelore*, pasi në datën 30.7.2025, nisur nga gjendja e rënduar shëndetësore, ai i është drejtuar sërish GJKKO-së të Shkallës së Parë me kërkesë për zëvendësimin e masës së sigurimit personal me një masë më të butë. Me vendimin nr. 531, datë 31.7.2025, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka rrëzuar kërkesën e tij për zëvendësimin e masës, si dhe ka rrëzuar kërkesën e mbrojtësit për të marrë kartelën klinike në cilësinë e provës, duke refuzuar në këtë mënyrë prova mjekësore të specializuara, duke vënë në rrezik të drejtpërdrejtë jetën e kërkuesit, për aq kohë sa IEVP-ja, Fier nuk mund t'i ofrojë atij as terapinë e nevojshme të përditshme, as regjimin ushqimor të posaçëm, dhe as monitorimin e vazhdueshëm mjekësor që kërkon gjendja e tij.

18. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme,*** në mënyrë të përmbledhur, për themelin e çështjes, ka prapësuar si vijon:

18.1 Pretendimi për cenimin e *parimit të prezumimit të pafajësisë dhe parimit të paanshmërisë* nuk qëndron, pasi GJKKO-të dhe Gjykata e Lartë kanë përmbushur detyrimin e tyre kushtetues për respektimin e parimit të prezumimit të pafajësisë në vlerësimin e provave, nuk kanë zhvendosur barrën e provës te kërkuesi, nuk kanë nxjerrë prezumime fakti të paarsyeshme, si dhe e kanë përcaktuar dyshimin e arsyeshëm të të hetuarit në fazën e caktimit të masës së sigurimit.

18.2 Pretendimi për cenimin e *parimit të sigurisë juridike* nuk qëndron, pasi shkaqet e parashtruara nga kërkuesi kanë për objekt vendimin nr.18 (87-2024-123), datë 3.5.2024 të GJKKO-së së Apelit, i cili nuk është objekt i ankimit kushtetues individual, për më tepër është prishur nga Gjykata e Lartë me vendimin nr. 232, datë 26.9.2024, ndaj nuk prodhon efekte të një vendimi gjyqësor për sa i përket arsyes së prishjes së tij. Më konkretisht në arsyetimin e vendimit citohet se gjyqtari i hetimit paraprak nuk mund të marrë kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprake dhe se kjo ndërhyrje e gjyqtarit të hetimit paraprak në veprimtarinë e prokurorit, duke bërë kualifikim të faktit penal, është jashtë kompetencave të funksionit të gjyqtarit të hetimit paraprak.

18.3 Pretendimet për cenimin e *standardit të dyshimit të arsyeshëm dhe të proporcionalitetit* nuk qëndrojnë, pasi referuar praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë, më konkretisht vendimeve unifikuese nr. 3, datë 27.9.2002 dhe nr. 7, datë 14.10.2011 (*vendimi nr. 7/2011*) të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova është një nga kushtet e domosdoshme në caktimin e masës së sigurimit "Arresti në burg", sikurse dhe rreziku i ndërhyrjes në marrjen e provave, rreziku i ikjes së personit ose kryerjes së veprave të tjera penale prej tij, si dhe shkalla e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale. Vendimet e GJKKO-ve dhe të Gjykatës së Lartë nuk kanë bërë një arsyetim stereotip për plotësimin e kushteve dhe të kritereve të përgjithshme, por i kanë ballafaquar kërkesat ligjore me rastin konkret dhe veprimet hetimore konkrete të ndërmarra në kuadër të këtij procedimi penal. Vendimmarrjet e GJKKO-ve dhe e Gjykatës së Lartë referojnë në praktikën e GJEDNJ-së dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, si dhe në vendimet unifikuese nr. 1, datë 8.1.2009 (*vendimi nr. 1/2009*) dhe nr.7/2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Gjithashtu, nuk qëndron arsyetimi i kërkuesit se vetë avancimi i hetimeve passjell zbutjen e nevojave të sigurimit si një konstatim ekstraligjor, i cili nuk i përgjigjet cilësisë që merr subjekti procedural nga personi nën hetim gjatë hetimit paraprak, në të pandehur në çdo shkallë të procesit, që përfundon me vendimin e gjykatës e që bashkëshoqërohet me masën e sigurimit personal, sipas specifikimeve të rastit konkret.

18.4 Për sa i përket pretendimit të kërkuesit *për konstatimin e shkeljes të të drejtave dhe lirive themelore të tij, si dhe marrjen e masave të nevojshme për rivendosjen e rendit kushtetues*, që lidhet me vendimin nr. 531, datë 31.7.2025, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, mbështetur në nenin 131, shkronja "f", të Kushtetutës, kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive përpara se t'i drejtohet Gjykatës, pasi vendimi është për shqyrtim në GJKKO-në e Apelit.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

19. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të

drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si edhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

20. Në lidhje me legjitimimin *ratione personae,* Gjykata konstaton se objekt i këtij ankimi kushtetues individual janë vendimet gjyqësore të të tria shkallëve të gjykimit që kanë disponuar për informacionin dymujor të Prokurorisë së Posaçme dhe zëvendësimin e masës së sigurimit personal, duke vendosur vijimin e zbatimit të masës së sigurimit personal "Arresti në burg". Në momentin e paraqitjes së ankimit kushtetues individual (30.4.2025) kërkuesi vijonte të ishte nën këtë masë sigurimi, që është ndryshuar në vijim me vendimin e datës 10.10.2025, të GJKKO-së së Apelit, e cila ka vendosur ndaj tij masën "Arresti në shtëpi". Megjithatë, pavarësisht se në momentin e shqyrtimit të ankimit kushtetues individual masa e sigurimit është zëvendësuar me një masë më të lehtë, kërkuesi e mbart ende statusin e viktimës, pasi gjykatat e zakonshme nuk e kanë njohur/korrigjuar shkeljen e së drejtës që pretendohet se është shkelur. Sikurse ka pohuar edhe Gjykata në vendimmarrjen e saj, ndryshimi i nevojave të sigurimit, për pasojë vendimet gjyqësore që ndryshojnë masat e sigurimit *in melius*, nuk mund të konsiderohen si korrigjime të shkeljes së pretenduar *(shih vendimin nr. 1, datë 17.1.2025, të Gjykatës Kushtetuese)*. Pra, pavarësisht se masa e sigurimit "Arresti në burg" e kundërshtuar nga kërkuesi nuk është më në fuqi për shkak të ndryshimit të saj dhe, për rrjedhojë, vendimet objekt kërkese nuk sjellin më pasoja ndaj tij, kjo nuk ndryshon faktin se ai ka qenë duke vuajtur një masë të heqjes së lirisë, për të cilën pretendon se është jokushtetuese dhe në kundërshtim me liritë dhe të drejtat e tij. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae* si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial, pasi jo vetëm ka qenë palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, por provon edhe interesin e drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

21. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive,* që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja "f", i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja "a", i Ligjit Organik të Gjykatës. Shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me funksionin subsidiar të mbrojtjes kushtetuese, që mund të kërkohet vetëm për një vendim gjyqësor përfundimtar që përmbyll procesin gjyqësor (*shih vendimet nr. 5, datë 22.2.2022; nr. 29, datë 30.3.2017; nr. 28, datë 23.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, Gjykata ka përfshirë në juridiksionin kushtetues edhe vendimet gjyqësore që lidhen me masat e sigurimit të arrestit në burg, përfshirë ato që kanë të bëjnë me kontrollin periodik të prokurorisë, duke arsyetuar se karakteri i këtij vendimi, që lidhet me heqjen e lirisë së individit, si përjashtim, e bën atë një vendim përfundimtar, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 17, datë 13.3.2024; nr. 14, datë 11.3.2021; nr. 28, datë 23.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Prandaj, Gjykata konstaton se vendimet gjyqësore për zëvendësimin e masës së sigurimit, të kundërshtuara nëpërmjet këtij ankimi kushtetues individual, të cilat janë dhënë në vijim të informacionit dymujor të prokurorisë, konsiderohen përfundimtare në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja "a", të Ligjit Organik të Gjykatës.

22. Po në lidhje me kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive, Gjykata ka theksuar se ai kërkon që kërkuesi t'u jetë drejtuar të gjithave shkallëve të ankimit dhe që pretendimet që parashtrohen përpara kësaj Gjykate të jenë paraqitur më parë në gjykatat e zakonshme, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural *(shih vendimet nr. 5, datë 9.2.2023; nr. 12, datë 9.3.2021; nr. 8, datë 19.3.2018, të Gjykatës Kushtetuese)*.

23. Gjykata vëren se kërkuesi, në aspektin formal, i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual, pasi ka shteruar mjetet e zakonshme të ankimit përpara gjykatave të zakonshme të të tria shkallëve të gjykimit. Për sa i përket aspektit substancial të këtij kriteri, kërkuesi, ndër të tjera, ka pretenduar cenimin e të drejtave dhe lirive themelore të tij, pasi në datën 30.7.2025, nisur nga gjendja e rënduar shëndetësore, ai i është drejtuar sërish GJKKO-së së Shkallës së Parë me kërkesë për zëvendësimin e masës së sigurimit personal me një masë më të butë, por me vendimin nr. 531, datë 31.7.2025, GJKKO-ja e Shkallës së Parë e ka rrëzuar kërkesën e tij, duke vënë në rrezik të drejtpërdrejtë jetën e kërkuesit, për aq kohë sa IEVP-ja, Fier nuk mund t'i ofrojë atij kushte të përshtatshme për gjendjen e tij. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se kërkuesi, mbështetur në nenin 131, shkronja "f", të Kushtetutës, nuk ka shteruar mjetet juridike efektive përpara se t'i drejtohet Gjykatës, pasi vendimi nr. 531, datë 31.7.2025, i GJKKO-së së Shkallës së Parë është ankimuar nga kërkuesi dhe është për shqyrtim në GJKKO-në e Apelit.

24. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata konstaton se vendimi nr. 531, datë 31.7.2025, i GJKKO-së së Shkallës së Parë, me të cilin nuk është pranuar kërkesa për zëvendësimin e masës së sigurimit, për shkak të gjendjes shëndetësore, nuk është objekt i këtij gjykimi kushtetues, ndaj, në këto rrethana, çdo pretendim për këtë vendim nuk mund të merret në shqyrtim nga Gjykata, pasi kërkuesi ka mjete të tjera në dispozicion në lidhje me të.

25. Për pretendimet e tjera që lidhen me kundërshtimin e vendimeve të cituara në objektin e vendimit, Gjykata vlerëson se kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor dhe pasi ka shteruar në formë dhe në substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta për zëvendësimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues "Arresti në burg", për rrjedhojë ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

26. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, i datës 4.12.2024, është publikuar në faqen e saj zyrtare në datën 6.1.2025, që rezulton të jetë gjithashtu data në të cilën përfaqësuesit ligjor të kërkuesit i është njoftuar në mënyrë elektronike vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Penal, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 30.4.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

27. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae* në ankimin kushtetues individual, kërkuesi i ka parashtruar pretendimet e tij në drejtim të cenimit të: a) lirisë personale në aspekt të mungesës së dyshimit të arsyeshëm dhe proporcionalitetit të masës së sigurimit personal; b) së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të parimit të paanshmërisë, sigurisë juridike dhe prezumimit të pafajësisë.

28. Gjykata, në rastin e masave të sigurimit, ka pohuar se ajo i trajton pretendimet në drejtim të lirisë personale, si e drejtë substanciale, ndërsa pretendimet për proces të rregullt i trajton si aspekte procedurale të lirisë personale, duke u ndalur në aspekte të veçanta, për sa ato mund të ndikojnë drejtpërdrejt në të drejtën substanciale në vetvete *(shih vendimet nr. 81, datë 21.11.2024; nr. 29, datë 16.4.2024; nr. 18, datë 19.3.2024, të Gjykatës Kushtetuese)*. Në këtë këndvështrim, Gjykata çmon të analizojë në themel pretendimet për cenimin e *lirisë personale në aspektin procedural dhe në aspektin substancial* lidhur me vazhdimin e masës së sigurimit personal "Arresti në burg", bazuar në informacionin dymujor të Prokurorisë së Posaçme. *Në aspektin procedural,* Gjykata vëren se ndonëse kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të paanshmërisë, parimit të sigurisë juridike dhe të prezumimit të pafajësisë, në thelb, pretendimet e tij kanë të bëjnë me vendimmarrjen e gjykatës së apelit, e cila ka marrë kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprake, duke ushtruar kontroll mbi veprimtarinë e prokurorit, nëpërmjet kualifikimit të veprës penale, ndaj Gjykata çmon

t'i analizojë në drejtim të parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme. *Në aspektin substancial*, nisur nga thelbi i pretendimeve të kërkuesit, Gjykata çmon t'i analizojë në drejtim të *parimit të proporcionalitetit* për përshtatshmërinë e vazhdimit të masës së kufizimit të lirisë personale.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për aspektin procedural

B.1.1 Për cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme

29. Kërkuesi ka pretenduar se GJKKO-ja e Apelit ka tejkaluar kufijtë e shqyrtimit në gjykatën e apelit, duke shtuar fakte e akuza që nuk janë pretenduar as nga prokurori dhe as nga gjykata e shkallës së parë, duke e rikualifikuar faktin penal, duke rënduar pozitën e kërkuesit e duke caktuar një masë sigurimi ekstreme në mungesë totale të arsyetimit. Sipas tij, ndonëse çështja është kthyer për rigjykim nga Gjykata e Lartë, GJKKO-ja e Apelit ka mbajtur të njëjtin qëndrim si në vendimmarrjen e saj të mëparshme, me doza të thella paragjykimi dhe me bindje të plotë për fajësinë e kërkuesit. GJKKO-ja e Apelit e ka konsideruar kërkuesin dhe personat nën hetim si fajtorë, ndonëse çështja ndodhet ende në fazën e hetimeve, si dhe ka vlerësuar se ka veprime hetimore të mëtejshme që e konsolidojnë bindjen për autorësinë e tij dhe të personave të tjerë nën hetim.

30. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se gjykatat e posaçme dhe Gjykata e Lartë kanë përmbushur detyrimin e tyre kushtetues për respektimin e parimit të prezumimit të pafajësisë në vlerësimin e provave, nuk kanë zhvendosur barrën e provës te kërkuesi, nuk kanë nxjerrë prezumime fakti të paarsyeshme, si dhe e kanë përcaktuar dyshimin e arsyeshëm të të hetuarit në fazën e caktimit të masës së sigurimit. Sipas subjektit të interesuar, parimi i sigurisë juridike nuk qëndron, pasi shkaqet e parashtruara nga kërkuesi kanë për objekt vendimin nr. 18, datë 3.5.2024, të GJKKO-së së Apelit, i cili nuk është objekt i ankimit kushtetues individual, për më tepër është prishur nga Gjykata e Lartë me vendimin nr. 232, datë 26.9.2024, ndaj nuk prodhon efekte të një vendimi gjyqësor për sa i përket arsyes së prishjes së tij.

31. Lidhur me parimin e sigurisë juridike dhe pritshmëritë e ligjshme, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se ai nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit te shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin (*shih vendimin nr. 11, datë 21.4.2022, të Gjykatës Kushtetuese)*. Për sa u përket të drejtave të fituara si elementë të parimit të sigurisë juridike, Gjykata është shprehur se çdo proces ku vihen në dyshim të drejtat e fituara, nuk mund të konsiderohet se qëndron jashtë nocionit të "procesit të rregullt", përderisa diskutohet e vendoset për këto të drejta të fituara. Ky parim është i detyrueshëm të respektohet në të gjitha fazat e një procesi ku pretendohet cenimi i të drejtave të fituara dhe siguria juridike që rrjedh prej tyre (*shih vendimet nr. 22, datë 29.9.2022; nr. 10, datë 13.2.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

32. GJEDNJ-ja, gjatë shqyrtimit të ankimeve për lirinë personale, ka pohuar se parimi i sigurisë juridike mund të cenohet në rast se gjykatat vendase bëjnë një interpretim të gjerë që mohon garancitë procedurale të parashikuara me ligj (*shih Aydın Sefa Akay kundër Turqisë, datë 23.4.2024, § 115*).

33. Gjykata vëren se në procesin gjyqësor për shqyrtimin e informacionit periodik të prokurorisë dhe të kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit personal "Arresti në burg" me një masë më të butë, objekt i ankimit kushtetues individual, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin e datës 24.7.2024, nuk është shprehur për kualifikimin e faktit penal, ndërsa GJKKO-ja e Apelit, me vendimin e datës 31.7.2024, ka vlerësuar se ka dyshime të arsyeshme se personat e proceduar penalisht, ndër të cilët edhe kërkuesi, kanë konsumuar elementet e veprës penale të parashikuar nga neni 287 i KP-së, e kryer në kuadër të grupit të strukturuar kriminal si formë

bashkëpunimi e posaçme e parashikuar nga nenet 28, pika e katërt, dhe 334, pika e parë, i këtij kodi. Sipas asaj gjykate, ndryshe nga informacioni në gjykimin për caktimin dhe vazhdimin e masës së sigurimit personal për kërkuesin, në procesin penal për zëvendësimin e saj, hetimet paraprake të Prokurorisë së Posaçme kanë identifikuar një rreth personash fizikë e juridikë që kanë bashkëvepruar me ata të proceduar tashmë penalisht ose të paproceduar, por të identifikuar, duke u qartësuar më shumë shkalla e lartë e realizimit të fajësisë, përmasat e mëdha të shtrirjes së bashkëpunëtorëve, jashtë dhe brenda institucioneve të shtetit, mënyra e bashkëpunimit në kryerjen e veprave penale dhe kontributi i secilit prej tyre. Për rrjedhojë, sipas GJKKO-së së Apelit, duhet të ndryshohet mënyra sesi GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka arsyetuar dhe ka konkluduar për emërtimin ligjor të fakteve penale historike të provuara në këtë procedim penal, duke mos u pajtuar me kualifikimin juridik të realizuar për to nga Prokuroria e Posaçme. Gjykata e Lartë, me vendimin e datës 4.12.2024, objekt i ankimit kushtetues individual, ka vlerësuar se pretendimet e kërkuesit për marrjen e kompetencave të gjyqtarit të seancës paraprake nga GJKKO-ja e Apelit për kualifikimin ndryshe të bashkëpunimit nga ai i thjeshtë, në grup të strukturuar kriminal, janë marrë në shqyrtim në procesin gjyqësor për caktimin dhe vazhdimin e masës së sigurimit personal, në të cilin Gjykata e Lartë, me vendimin e datës 26.9.2024, ka vendosur, ndër të tjera, prishjen e vendimit të GJKKO-së së Apelit, duke e dërguar çështjen për rishqyrtim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues, pasi ka evidentuar se gjyqtari i hetimit paraprak në gjykatën e apelit ka marrë kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprake, duke ushtruar kontroll mbi veprimtarinë e prokurorit nëpërmjet kualifikimit të veprës penale. Prandaj, në rastin në shqyrtim, Gjykata e Lartë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të GJKKO-së së Apelit.

34. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se qëndrimi i mbajtur nga GJKKO-ja e Apelit për ekzistencën e elementeve të veprave penale të ndryshme nga ato të evidentuara fillimisht, nuk përbën ngritje të një akuze të re ndaj kërkuesit, por lidhet me vlerësimin e nevojave të sigurimit personal dhe analizën e rrethanave konkrete të çështjes. Nga ana tjetër, pavarësisht se Gjykata e Lartë nuk e ka kthyer çështjen për rigjykim në rastin konkret, evidentimi prej saj i faktit se ky pretendim ishte trajtuar tashmë dhe se i ishte dhënë përgjigje në procesin gjyqësor të caktimit të masës së sigurimit personal, përmbush kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për parimin e sigurisë juridike dhe të pritshmërive të ligjshme.

35. Në këndvështrim të sa më sipër, Gjykata çmon se shkelja e pretenduar nuk ka ndikuar në mënyrë konkrete në vendimmarrjen e gjykatave për masën e sigurimit personal dhe as nuk ka sjellë rëndim të pozitës procedurale të kërkuesit. Për më tepër, për sa kohë kërkuesi ka ushtruar të drejtën e rekursit dhe pretendimet e tij janë shqyrtuar nga Gjykata e Lartë, e cila i ka dhënë përgjigje këtij pretendimi, nuk rezulton të jenë cenuar garancitë procedurale të parashikuara nga KPP-ja. Për rrjedhojë, pretendimi për cenimin e lirisë personale, në aspektin procedural në drejtim të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme, është i pabazuar.

B.2 Për aspektin substancial

B.2.1 Për cenimin e lirisë personale të lidhur me parimin e proporcionalitetit

36. Kërkuesi ka pretenduar se GJKKO-të dhe Gjykata e Lartë nuk e kanë pranuar kërkesën e tij për zëvendësimin e masës "Arresti në burg" me një masë më të lehtë, edhe pse gjatë periudhës së kryerjes së hetimeve ai nuk ka ndërmarrë ose tentuar ndonjë veprim të çfarëdoshëm për të dëmtuar provat, apo për t'u larguar, duke e bërë masën e caktuar ndaj tij joproporcionale me akuzat në ngarkim të tij dhe me situatën faktike në momentin e caktimit të kësaj mase kur ishin kryer hetimet.

37. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se GJKKO-të dhe Gjykata e Lartë nuk kanë bërë një arsyetim stereotip për plotësimin e kushteve dhe të kritereve të përgjithshme,

por i kanë ballafaquar kërkesat ligjore me rastin në shqyrtim dhe me veprimet hetimore konkrete të ndërmarra në kuadër të këtij procedimi penal. Vendimmarrja e gjykatave referon në praktikën e GJEDNJ-së dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, si dhe në vendimet unifikuese nr. 1/2009 dhe nr. 7/2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

38. Neni 27, pika 1, i Kushtetutës parashikon se askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj *(pika 1)* dhe se liria e personit nuk mund të kufizohet, përveçse në rastin kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj *(pika 2, shkronja "c")*. Në nenin 28 të Kushtetutës janë parashikuar garancitë procedurale në rastet e heqjes së lirisë, ku përfshihet edhe e drejta për t`iu drejtuar gjykatës dhe për të pasur një gjykim brenda një afati të arsyeshëm ose për t`u proceduar i lirë përkundrejt një garancie pasurore sipas ligjit.

39. Gjykata ka pohuar se kushtet, kriteret dhe procedurat gjyqësore për rivlerësimin dhe zëvendësimin e arrestit në burg janë drejtpërdrejt të lidhura me respektimin e lirisë së personit (*shih vendimet nr. 51, datë 18.10.2023; nr. 19, datë 4.4.2023; nr. 40, datë 18.7.2012, të Gjykatës Kushtetuese*). Masa e sigurimit personal mund dhe duhet të ndryshohet, duke u zëvendësuar me një masë më të lehtë ose më të rëndë, në varësi të ndryshimit të kushteve që ekzistonin kur ajo është caktuar *(shih vendimet nr. 40, datë 14.5.2024; nr. 28, datë 23.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese)*.

40. Gjykata në jurisprudencën e saj gjithashtu ka pohuar se, në përputhje me nenin 27, pika 2, shkronja "c", të Kushtetutës, caktimi i arrestit në burg kërkon ekzistencën e disa kushteve të përgjithshme dhe të veçanta, përfshirë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova se individi ka kryer një vepër penale *(neni 228 i KPP-së)*, si dhe përmbushjen e disa kritereve të veçanta (*neni 230 i KPP-së*). Vijimi i ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm është një kusht *sine qua non* për vlefshmërinë edhe të vazhdimit të paraburgimit. Megjithatë ka një dallim të dukshëm midis situatës kur gjykatat shqyrtojnë për herë të parë, "menjëherë" pas arrestimit, nëse personi i dyshuar do të qëndrojë në paraburgim, me situatën kur pas një kohe të caktuar nevojitet vijimi i masës së arrestit. Në këtë rast të fundit, me kalimin e kohës, dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova nuk mjafton. Prandaj, organet proceduese duhet të japin njëkohësisht arsye të qarta, relevante dhe të mjaftueshme për të justifikuar vijimin e paraburgimit, konform rrethanave individuale të secilit rast penal (*shih vendimet nr. 7, datë 28.1.2026; nr. 86, datë 30.12.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

41. Po në këtë këndvështrim, në lidhje me kohëzgjatjen e arrestit, Gjykata ka pohuar se çështja nëse një periudhë kohore e kaluar në paraburgim është e arsyeshme nuk mund të vlerësohet në mënyrë abstrakte, por në bazë të fakteve të secilit rast dhe veçorive të tij specifike. Prandaj, vazhdimi i paraburgimit mund të justifikohet në një rast të caktuar vetëm nëse ka tregues specifikë të një kërkese të vërtetë të interesit publik, e cila, pavarësisht nga prezumimi i pafajësisë, tejkalon rregullin e respektimit të lirisë individuale të përcaktuar në nenin 27 të Kushtetutës dhe nenin 5 të KEDNJ-së (*shih vendimin nr. 86, datë 30.12.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

42. Në përmbledhje të sa më lart dhe nisur nga konteksti i çështjes në shqyrtim, Gjykata thekson se, në kuptim të nenit 28, pika 3, të Kushtetutës, në lidhje me nenin 27 të saj dhe nenin 5, paragrafi 3, të KEDNJ-së, kalimi i kohës në paraburgim përbën një faktor me rëndësi kushtetuese në kontrollin e vijimit të masës së sigurimit "arrest në burg". Megjithatë, ai në vetvete nuk sjell automatikisht zëvendësimin ose revokimin e masës, por rëndon barrën e organeve proceduese për të provuar se vijojnë të ekzistojnë kushtet dhe nevojat e sigurimit që e justifikojnë vijimin e paraburgimit. Në këtë kuptim, prokuroria duhet të tregojë se ka vepruar me kujdesin e nevojshëm dhe pa vonesa të pajustifikuara në kryerjen e veprimeve hetimore ose procedurale, ndërsa gjykata duhet të verifikojë, në mënyrë të pavarur dhe të individualizuar, jo vetëm vazhdimësinë e dyshimit

të arsyeshëm, por edhe nëse arsyet e tjera të paraqitura për mbajtjen e personit në paraburgim mbeten konkrete, të rëndësishme, të mjaftueshme dhe të domosdoshme. Po ashtu, gjykata duhet të shqyrtojë nëse, me kalimin e kohës, nevojat e sigurimit që kanë përligjur fillimisht masën vazhdojnë të jenë reale dhe aktuale, si dhe nëse ato mund të garantohen nëpërmjet garancisë pasurore ose masave të tjera më të lehta të sigurimit. Kjo analizë duhet të zhvillohet në mënyrë të individualizuar, duke iu përgjigjur fakteve dhe rrethanave specifike të rastit konkret, pa e zhvendosur barrën te personi i paraburgosur për të provuar arsyet që justifikojnë lirimin e tij. Kjo nuk përjashton detyrimin e personit të paraburgosur që rrethanat që zbusin nevojat e sigurimit, t'ua bëjë të ditura organeve proceduese konform nenit 260 të KPP-së.

43. Gjykata konstaton se objekti i ankimit kushtetues individual lidhet me kërkesat e personave nën hetim, ndër të cilët edhe kërkuesi, me objekt shqyrtimin e informacionit dymujor të Prokurorisë së Posaçme për periudhën 28.3.2024–28.5.2024, për ecurinë e hetimeve dhe vlerësimin e kushteve e të kritereve të zbatimit të masave të sigurimit, si dhe zëvendësimin e masës së sigurimit në zbatim ndaj tij, me një masë sigurimi më të butë. Prandaj, Gjykata do të analizojë nëse në rastin konkret gjykatat kanë arsyetuar mjaftueshëm veprimet e kryera nga Prokuroria e Posaçme dhe të paraqitura në informacionin dymujor, pra nëse ky i fundit përbënte një informacion formal dhe të përgjithshëm, ose ishte i detajuar në drejtim të forcimit apo zbehjes së dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova, si dhe nëse është respektuar kriteri kushtetues i proporcionalitetit për justifikimin e vijimit të zbatimit të masës së sigurimit "Arresti në burg".

44. Gjykata konstaton se GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se, në drejtim të kontrollit mbi ecurinë e hetimeve dhe vlerësimit të diligjencës së organit të hetimit në kryerjen e tyre gjatë zbatimit të masës së sigurimit "Arresti në burg" ndaj personave nën hetim, Prokuroria e Posaçme ka kryer një sërë veprimesh hetimore për procedimin në tërësi, sikurse vendimet e datave 2.4.2024, 22.4.2024, 29.3.2024 (8 vendime) për caktimin e ekspertëve për kryerjen e ekspertimeve teknike të pajisjeve elektronike dhe ato teknike vlerësuese për përcaktimin e marzhit të fitimit të shoqërisë, si dhe mënyrën e përllogaritjes së fondit limit në procedurat e prokurimit objekt procedimi. GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se kërkimet e mbrojtjes për zëvendësimin e masave të sigurimit personal nuk janë të bazuara, pasi kushtet e përgjithshme dhe të posaçme për caktimin e masave dhe përshtatshmëria e tyre, nuk rezultojnë të kenë pësuar ndryshime thelbësore e, për pasojë, personat nën hetim vijojnë të jenë në procedim hetimi për të njëjtat fakte, për të njëjtat vepra penale, por duke u paraqitur pozita e tyre në raport me dyshimin e arsyeshëm në një fazë më të avancuar, pasi për disa prej akuzave subjektet kanë marrë cilësinë e të pandehurve. Sipas asaj gjykate, kushtet e posaçme për caktimin e masave të sigurimit dhe ato lidhur me përshtatshmërinë e tyre që konsistojnë në prezencën e rrezikut të ikjes dhe të ndikimit në marrjen dhe vërtetësinë e provave, të vlerësuara më herët gjatë caktimit të masës, janë prezentë në të njëjtën mënyrë dhe masë edhe aktualisht, pasi nuk rezulton të kenë pësuar ndryshime thelbësore dhe në atë masë që të mund t'i nënshtrohen një vlerësimi të ndryshëm, për pasojë të jenë të afta të për të ndikuar për ridimensionimin e nevojave të sigurimit. Ajo gjykatë ka vlerësuar se kushtet e përgjithshme dhe të posaçme për caktimin e masave dhe përshtatshmëria e tyre nuk kanë pësuar ndryshime thelbësore, pasi personat nën hetim vijojnë të hetohen për të njëjtat vepra penale, të cilat mbartin të njëjtën rrezikshmëri shoqërore të vlerësuar në momentin fillestar nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë dhe të gjetur të drejtë dhe nga gjykata më e lartë që ka shqyrtuar ankimin e personave nën hetim, duke miratuar masat e caktuara prej tyre. Sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë, nuk është pretenduar zbulimi i ndonjë rrethane që ka ekzistuar në momentin e caktimit ose të rivlerësimit të masave të sigurimit, e panjohur në atë moment për palët dhe për gjykatën dhe as i ndonjë rrethane të re të ndodhur gjatë zbatimit të masës, e aftë për të ndikuar në ridimensionimin e nevojave të

sigurimit, në kuptim të nenit 260, pika 2, të KPP-së. Për rrjedhojë, në kushtet kur kërkuesi nuk ka argumentuar dhe nuk ka provuar ndryshim të rrethanave faktike dhe/ose ligjore, nuk mund të rivlerësohet edhe njëherë, por në mënyrë të ndryshme, të njëjtat fakte dhe rrethana që janë vlerësuar më herët prej saj. Po kështu, sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë, nuk rezultojnë të jenë bërë ndryshime të cilësimit ligjor të faktit penal për të cilin procedohet kërkuesi dhe personat e tjerë të pandehur, duke mos përligjur ndryshimin e masës së sigurimit personal me pasojë ridimensionimin e nevojave të sigurimit drejt lehtësimit të tyre, si dhe çështja është ende në fazën e hetimit paraprak dhe nuk rezulton asnjë e dhënë që të përligjë nevojën e zëvendësimit të masës së sigurimit personal.

45. Në vijim, GJKKO-ja e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë, me arsyetimin se në informacionin hetimor dymujor të Prokurorisë së Posaçme përmendet pikëpamja e ndryshme dhe më e rëndë për kualifikimin ligjor të fakteve nga GJKKO-ja e Apelit. Po kështu, sipas asaj gjykate, në materialin provues të mbledhur, çështja penale ndaj subjekteve të proceduara penalisht është gati për shqyrtim në themel dhe për dy personat nën hetim nuk ka asnjë rrethanë që ka relativizuar rëndësinë juridike dhe faktike të fakteve penale historike, të cilat u atribuohen, përkundrazi ka veprime hetimore të mëtejshme që e konsolidojnë bindjen për autorësinë e tyre dhe për aktivizimin e përgjegjësisë penale të rezultuara deri më tani se janë konsumuar sipas pikëpamjes juridike të ndryshme të GJKKO-së së Apelit. Sipas asaj gjykate, pretendimet e kërkuesit për refuzimin ose pasivitetin e Prokurorisë së Posaçme për ta marrë në pyetje për sa dyshohet dhe mosdhënien e mundësisë për të sqaruar pozicionin e tij, janë të pabazuara, pasi kërkuesi ka zgjedhur me vullnetin e tij të lirë të gjykohet në mungesën e tij fizike dhe të vijojë gjykimin në të dyja shkallët gjyqësore vetëm me prezencën e mbrojtësit të zgjedhur në gjykimin e verifikimit të masës së sigurimit personal, si dhe në gjykimin për zëvendësimin e masës, por edhe kur ka marrë pjesë ka refuzuar të marrë fjalën, të bëjë deklarime në gjykim ose të pyetet nga gjykata, duke dëshmuar se kërkuesi nuk ka kërkuar të bashkëpunojë ose të kontribuojë në realizimin e hetimit të plotë e të gjithanshëm.

46. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të GJKKO-së së Apelit, duke vlerësuar se gjykatat e faktit kanë marrë në shqyrtim informacionin dymujor mbi gjendjen e procedimit penal, si dhe kërkesën për zëvendësimin e masës së sigurimit, ku gjerësisht është arsyetuar se nevojat e sigurimit nuk janë zbutur. Sipas Gjykatës së Lartë, shkaqet e paraqitura në rekurs nuk janë të tilla që të cenojnë vendimmarrjen e GJKKO-së së Apelit, si dhe nuk ka mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural, me rëndësi për zhvillimin ose njësimin e praktikës gjyqësore, nuk ka mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit procedural, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave, vendimi i ankimuar nuk bie në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe, për pasojë, nuk ndodhet në asnjë nga rastet e parashikuara nga neni 432 i KPP-së në kohen e depozitimit.

47. Në këndvështrim të sa më lart, në analizë të vendimmarrjes së gjykatave të posaçme dhe të Gjykatës së Lartë për informacionin dymujor të paraqitur nga Prokuroria e Posaçme, Gjykata konstaton se ato kanë analizuar në mënyrë konkrete nevojën për vijimin e masës së sigurimit, duke vlerësuar se rrethanat që justifikuan vendosjen fillestare të saj vazhdojnë të jenë të pranishme edhe në momentin e shqyrtimit periodik, si dhe Prokuroria e Posaçme ka treguar diligjencën e duhur në ushtrimin e ndjekjes penale dhe mbledhjen e provave të mëtejshme.

48. Në këtë drejtim, Gjykata evidenton se gjykatat kanë arsyetuar kriterin e rrezikut të largimit, me qëllim shmangien e procedimit penal, pra rrezikut të arratisjes së kërkuesit, duke dhënë arsye se përse në këtë rast plotësohet kriteri i nenit 228 të KPP-së, shkronja “b”, dhe të rrezikut për të

ndikuar në marrjen dhe vërtetësinë e provave, duke argumentuar në këtë drejtim se kërkuesi në rast se do të gjykohej i lirë ose në një masë tjetër më të lehtë sigurie, do të ndikonte ose do të pengonte procesin e të provuarit dhe vërtetimin e rrethanave të faktit të lidhura me procedimin penal, duke vënë kështu në rrezik dhënien e drejtësisë. Arsyetimi i gjykatave në këtë drejtim është i mjaftueshëm, pasi ai evidenton edhe faktin se prokuroria nuk ka arritur të marrë të gjitha provat që lidhen me procedimin penal, duke mos u zbehur kësisoj nevojat e sigurimit.

49. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se gjykatat e zakonshme nuk janë mjaftuar me një ripërsëritje automatike të arsyeve që kanë justifikuar vendosjen fillestare të masës së sigurimit, por kanë ushtruar një kontroll të përditësuar për domosdoshmërinë e vijimit të saj, çka përmbush kriterin kushtetues të vlerësimit prej gjykatave të zakonshme të nevojave të sigurimit në mënyrë të individualizuar. Në rastin konkret, informacioni dymujor i paraqitur nga Prokuroria e Posaçme nuk është trajtuar në mënyrë formale ose mekanike, por është analizuar si element i ri në funksion të këtij kontrolli periodik. Nga përmbajtja e vendimeve rezulton se gjykatat, nga pikëpamja kushtetuese, kanë kryer një vlerësim të mjaftueshëm të veprimeve hetimore të ndërmarra gjatë periudhës përkatëse, duke evidentuar personat e pyetur, natyrën e deklarimeve të tyre dhe provat e administruara. Ky informacion është konsideruar si tregues i progresit real të hetimit dhe si element që vazhdon të mbështesë dyshimin e arsyeshëm ndaj kërkuesit.

50. Në këto kushte, në rastin konkret, gjykatat kanë arsyetuar mjaftueshëm për proporcionalitetin e vazhdimit të masës, duke arsyetuar edhe në drejtim të "masës së duhur", pra nëse ajo vazhdonte të ishte e "përshtatshme" në raport me nevojat e sigurimit. Po kështu, ato (gjykatat) në arsyetimin e tyre, në kuadër të vlerësimit të përshtatshmërisë së vazhdimit të masës së sigurimit personal, krahas rrezikut që diktonte dhe justifikonte vazhdimin e saj, e kanë analizuar dhe vlerësuar atë edhe në raport me rëndësinë e faktit, rrezikshmërinë e lartë të veprës penale dhe pasojat e ardhura prej saj si dhe pse nuk plotësoheshin kushtet dhe kriteret ligjore për zëvendësimin e saj. Gjykatat e zakonshme, krahas analizës së ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm dhe diligjencës së prokurorisë, kanë vlerësuar sesi dhe sesa koha e kaluar ka ndikuar dhe diktuar në nevojat e sigurimit, duke konkluduar vijimin e masës së sigurimit të arrestit në burg. Për pasojë, vazhdimi i kufizimit të lirisë personale të kërkuesit nuk rezulton të jetë në kundërshtim me nenin 28, pika 3, të Kushtetutës, nenin 5, pika 3, të KEDNJ-së, dhe dispozitat ligjore përkatëse të KPP-së që përcaktojnë procedurat e kufizimit të kësaj lirie. Në përfundim të kësaj analize, Gjykata vlerëson se shkaqet e dhëna nga gjykatat e posaçme dhe nga Gjykata e Lartë, nga pikëpamja kushtetuese, janë të mjaftueshme për të justifikuar vazhdimin e masës së sigurimit "Arresti në burg". Për rrjedhojë, pretendimi për *cenimin e lirisë personale në aspektin substancial të lidhur me parimin e proporcionalitetit,* është i pabazuar.

51. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit janë të pabazuara, sipas arsyetimit të mësipërm, ndaj kërkesa rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 26.3.2026.

Shpallur më 10.6.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Ilir Toska, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini, Genti Ibrahimi, Sandër Beci, Asim Vokshi